

DËNESTE BASHKË ME ERËN

ADEM ZAPLLUZHA

DËNESTE BASHKË ME ERËN

Redaktor:
Izet Shala

Recensent:
Izet Shala

Lektor:
Veli Veliu

DËNESTE BASHKË ME ERËN

ADEM ZAPLLUZA

DËNESTE BASHKË ME ERËN

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

Për veprën „Dëneste bashke me erën”

Adem Zaplluzha

Njëqind libra poetik, dhjetëmijë poezi dhe mbi njëqindmijë vargje, Adem Zaplluzha

Autori Adem Zaplluzha me vëllimin më të ri poetik,, “Dëneste bashke me erën”, na afron vlerën dhe peshën e vargut që mbartë në brendi mesazhin e së vërtetës dhe mashtrimit duke demantuar ilozionistët, rrahagjoksët e së djeshmes për të sotmen dhe të nesërmen.

Po kush më mire se poeti ndjen realitetin dhe notën e mashtrimit sot, për të dhënë qëndrueshmërinë , faktin e fjalës dhe moralin e saj, deklamojmë vargjet në poezinë „ Atje në fund të lagjes”, Një copë mjegull bënë një hije, e cila i përngjanë hijes së arrës së egër, ku plakat e lagjes i krehin flokët e thinjura të erës”. Edhe sapo fillojnë sekondat e mbarimi i minutave të fundit poeti nuk ndalet pa trajtuar ngjarjet e ditës që shkaktojnë ndjenjat e këqija të njerëzve apo edhe të mirat e tyre.

Monstrumi poetiko-portretiv që sot luan tri seritë e ditës me fatin e Kosovës si : Të Foshnjës që kërkon ngrohtësinë e nënës, të rinjve që kërkojnë këshillën dhe dijen universitare dhe të

moshuarve që dhanë djersën për të djeshmen, të sotmen dhe të nesërmen, poeti nuk ngurron por vazhdon të jep nga vetja plotësimin e projektit se si do të dukej Kosova sot dhe nesër. Prandaj, sfida e tij është që me dhimbje të vogla të operoj fenomenologjinë apo dukurinë e meritokracisë dhe thurjes së odeve për të bëmat ndaj atdheut, dje, që sot kush pos dorës sime duhet të mbaj Flamurin e nacionalizmit. Shtrohet Pyetja sot mos vallë Kosova dhe shqiptarët kanë nevojë për bijtë e shekullit të ri të Migjenit apo Bijtë e askjut të Rexhep Qosjës? Kjo, nëse mund të quhet hipoteza qendrore mes analogjisë dhe antagonistes që poeti e sforcon te poezia „ Mu ata gur mermeri”, „Mbi një pllakë të kuqe mermeri, Lëri shenjat fillestare të erës, Pastaj shikoje Kosovën, përkulu te varret dhe nisu miku im, jeto këtu, nëse do mi shijua, pemët që rriten në syrin e lirisë”. këtu vargjet kumbojnë që njerëzit, që rrinë përsëri rrugës na kanë përcjellë, duke i folur njeri - tjetrit ne vesh këto vargje shprehin se si edhe tash analfabete lozin me trupin , ndjenjën e njeriut, kurse poeti dhe metafora recensioniste shprehet, Do të vij një kohë, dhe do të ngreh një monument lirie, ne hisen e plotë të gjeografisë kombëtare , vetëm për

heronjtë e mi, as kush nuk do të ketë guxim , të shkruaj a flas për ta si unë.

Në të dyja variantet, poeti fuqizon moralin i cili sot, sikur duket është liruar për nga vlera dhe shkon drejt degradimit të shoqërisë shqiptare.

Mendimi poetik divergjent, nuk kalon në sentimentalizëm, as defetizëm dhe as në pesimizmin e poetit, por mesazhi troket ndërgjegjshëm sot te shoqëria që po e ndërtojmë, prandaj kjo porosi sforcohet edhe më tej me veprimet direkte te vargjet që dirigjon keqas, ofron moral tt mykur, gjen vegza të molisura dhe të prishura ne unin e stërkequr Ja si qajmë ne pas vdekjes., Ky boshllëk, me fjalamani krye oxhaqeve,nuk njeh fytyrën e vet, ju thash as pushteti nuk është pushtet”. Mjaft i kemi share intelektualet , sa ishin gjallë, e sa here vdesin, i nderojmë, po i çmendim me fjalë të mira te varret, Mjaft më, heshtni, u qoftë turp, të gjithë kanë vdekur prej nesh. Këtu edhe poet te tjerë kanë analogjinë e situatave të vargut të Zaplluzhës. Poeti Adem Zaplluzha, shquhet si një nga depërtuesit e thellë të mendimit filozofik të etnosit tonë dhe kjo vërtetohet me vargjet e cituar më lartë, se është e vërtetë kjo filozofi e mbrapsht dëshmohet shumë nëse mundem të shprehem në mënyrë figurative a po përmes alegorisë, te

poezia,, Një stuhi nate, me vargjet **As ky shall nuk me duhet, kur e ve në qafë, më duket se atdheut po ia zë frymën, Atdheu s'duron të lidhet, faqe 64.**

Humbjen e etikës dhe degradimin e vlerave të mirëfillta. Këtë bindje time e sforcon vargu me metaforën me interesant të libri ,, Dëneste bashkë me erën". Shekuj me radhë lindjet i patëm nën hijet e lisave, edhe vdekjet tona u përngjajnë drurëve, Ecim maleve me një krenari epike, dhe për nga pamja u përngjanim gjyshërve...

E kam të mësuar se poeti apo poetet nuk kanë fund, prandaj edhe poeti Zaplluzha nuk ndalon me këtë vepër, por vazhdon sikur vazhdon populli rrugëtimin drejt majës për të parë se çfarë fshihet pas asaj.

*Autor,
Ma.sc. Izet Shala*

Prej shiu të tejdukshëm
Cikli i parë

MOS HARRO

Ecin

Depërtojnë tej e tej

frymëmarrjes së trupit

Dhe shpirtit tënd të brishtë

Njerëzit e dukshëm dhe të padukshëm

Ndjenjat e tua prej kallkani

I përngjajnë tejdukshmërisë së ujit

Një ditë bëhesh erë shakulline

Kurse tjetrën ditë

Si një hije morbide

Lexo epitafet në varret e shembura

Miku im kur kalamendesh rrugëve

Hapat e tua të tunxhta

Kanë shije të mjegullave

Ndalen te çezma, bisedojnë me hijet

Që iu përngjajnë tejdukshmërisë

Nëse një ditë kalon si i dehur

Nëpër kontrapunktin e trishtimit,

Mos harro

Se vetëm atë çast ti mund të jesh

Vetvetja e jote

Në përmbytjen e një gote të mbushur

Me pikëllimin e dallgëve te moli i vetmuar

NETËT JANË TË GJATA

Të lutem
Lëri të hapura mendimet
Unë sonte do të kthehem
Si përherë, nëpër të njëjtën itinerar
Nga kthehen shpirtrat shtegtarë të zogjve
Dhe të njerëzve klandestin.

Shiu as breshëri, s' do më pengojnë
Do kthehem nëpër tehun e shpatës
Së një beteje të lashtë
E cila ende nuk ka përfunduar
Në mendjet e shthurura të milingonave

Nëse ngjan e kundërta
Dhe si çdo herë ngjarjet marrin teposhtën
Të lutem
Më nxjerrë nga mendimet e tua
Më gjuaj diku në harresë
Po aty
Ku kujtesa i ka humbur të gjitha rrugët

Nëse humbi edhe unë, në humbjen time
Nuk do të mungojnë serenatat
Netët janë të gjata
Kur na shoqërojnë trishtimet e zogjve

SA ORA ZHDUKEJ NJERIU

Me peshën e shpirtit të ngrirë
Si me barrë të mbijetesës
Kalëroj nëpër hingëllimat e mjegullave

Pas jeleve të verdha
Rrokullisen kalldrëmet e murrme
Potkonjtë e kuajve të paçjerrë
Shtrihen si mendimet
Betejat e sapo të nisura në horizont
Duken shumë larg

Çfarë është kjo hije prej ylberi
Që zbret nga mali
Mos vallë është zgjuar nga legjenda
Gjoku i bardh i Gjergjit

Është zgjuar vetëdija e ekzistencës
Një valë e ngrohtë deti
I mban në duart e dallgëve të kripura
Amanetin e dizgjinëve
Të pakëputur

Nga dunat e fjetura të fjalëve
Si nëpër enigma
Mbinë shpirtrat e rrapeve

Nëpër mëhallë dalin në shesh plakat
Dhe u këndojnë djemurisë
U këndojnë ato këngë të ndaluara
Për të cilat
Sa ora zhdukej njeriu
Mëngjeseve të zbehta

SECILI PREJ NESH

Kur jam në mesin e të varfërve
Ora ndalet në stacion
Askund nuk udhëtojnë zogjtë
Si nëpër ëndrra
Përgjumen binarët e çelika

Nga portat hyrëse ngjashëm milingonave
kapërcejnë valixhet e drunjtë
Njerëzit u përngajnë kërpudhave
Kur qeshin
Duken shumë më qesharak
Se sa ndonjë gogol në thekërishte

Secili prej nesh
Fsheh mes tëlarave në valixhe
Ëndrrën e trishtuar të fëmijërisë
Kur vjen mesnata gëzohemi
Si të ishte nata e ndërrimit të moteve

Instinktivisht urojmë njëri - tjetrin
Për një ditë pakëz më ndryshe
Se sa dita paraprake
Që e lëmë te ora e vjetër

I zgjasim duart e shpresave
Deri te njeriu
Prej shiu të tejdukshëm
I zgjasim duart
Që t'i kapim rrezet e para të mëngjesit
I cili aspak nuk ndryshon
Nga mëngjeset e kaluara

ULEN VETËM NËPËR ATO VENDE

Është për t'u befasuar
Por lejlekët e verdhë ulen
Vetëm nëpër ato çati
Ku nuk banon më asnjë njeri

Mbase gjatë udhëtimit i humbin
Letrat e postuara
Humbin çdo gjë që quhet fluturim
Edhe memorien e harrojnë diku
Nëpër stepa të egra

Lejlekët e verdhë
Kanë diçka misterioze në shpirtrat e tyre
Andaj edhe u përngjajnë
Mjegullave prej letre
Nuk janë as shpirtra zogjsh
E as materie e ngurtë

Fluturojnë si nëpër ëndrra
Nuk u pëlqejnë stacionet e trenave
Thash më parë
Ulen vetëm nëpër ato vende
Ku nuk ka njerëz

EDHE NE ISHIM

Këto gjëra të imta
Që po i shohim sot nëpër dunat
E syve të rërës
Dikur nuk kanë ekzistuar

Këndeji pari ka qenë një zbrazëti
Që i përngjante
Tmerrësisht i përngjante
Boshllëkut të mendjes
Dhe fantazisë së një të sëmuri psikik

Ishte edhe një tjetër dyndje
Prej letre
E cila nuk kishte kurrfarë peshe
Por rëndonte
Më shumë se sa që rëndon guri i varrit

Jetonim si njerëz të vegjël
Mes gjerave të imta
Edhe ne ishim
Një copë mishi miniatural
Në kornizën e gozhduar të së kaluarës

DËNESIN FLUTURAT KRAH THYER

Diçka si një copë mishi
Po mbinë nga ky gur
Pikon një lloj balsami
I tejpushëm
Nën qemerët e ndryshkura të një ure
Dënesin fluturat krah thyer

Retë prej pluhuri ngjajnë grimcave
Të kuqe të erës
Një lloj tjetër e metamorfozës
Përtëritët për herë të tretë
Në shpirtin e paepur të mollës

Nga degët e fishkura të erës
Pikojnë dhe nuk ndalen
Stërkalat e shirave

Rrënjët e vetëtimave si nëpër balada
Shkreptijnë
Nëpër gjymtyrët e thyera të pritjes

Pas shpine një zë baritoni thërret
Dëgjohej si nga thellësira e tokës
Ulërima e zërit të ndërgjegjes
Një kohë asnjëse
Si kau i lodhur përtypet në parmendë

SËRISH I PASHË DY ZOGJ

Nuk dua të mos bëzaj sot
Jam zëri i frymëmarrjes
Nga duart e lisave pikojnë gjethet
Zogjtë prej letre
fluturojnë shumë larg
Më larg se ofshama zërit të lisit

Kur kthehen shtegtarët
Shtigjet janë më të gjëra
Dhe më të gjata se sa mendimet
Prej një ure të gurtë
Fluturojnë ca zogj të vendlindjes
Fluturojnë përtej përtejmes
Dhe unë sërish marr frymë si bari

Kur i krahasoj duart e mia prej hiri
Me frymëmarrjen e bretkosës
Ndjej se si në mua rritet krenaria
E zogjve të shenjtë
Por akoma nuk i kam mësuar
Fshehtësitë e fluturimit

Sërish i pashë dy zogj
Një pemë të egër dhe kapelën time
Kah i këndonin psalmet e harruara
Të erës lozonjare

KUR VINTE MBRËMJA

Më kujtohet
O fare mirë më kujtohen çastet
Kur ime ëmë
Ziente gur në një kusi bakri
Ishin do kohëra të liga
Ku qeni nuk e njihte të zotin

Natë e ditë valonte uji në kazan
E gurtë kurrsesi të zihen
Kurse fëmijët barkzbrazur
Si gjarpri me zile
Na kafshonte tërbim i urisë

Kur vinte mbrëmja
Gjumi shndërrohej në një ankth
Kryengritës të paepur
Dhe si me bisha të egra
Kacafytej me zhgjëndrrën
Deri në ringjalljen e mëngjesit

Sot kur më rikujtohen ato çaste
Rrëqethem si një luan i plagosur
Rrëqethem
Sa që i tërë trupi im
I përngjan urisë së ankthshme

ATJE NË FUND TË LAGJES

Shkas si ngjala e murrme shëtitores
Trotuareve blu
Kalojnë
E parakalojnë hijet e zbehta
Atje në fund të lagjes
Më pret shtëpia ime me çati të rrënuar

Po ajo shtëpi që para pak kohe
E humbi kapelën
E të reshurave të blerta

Mbi rrudhat e thinjura të borës
Bie një shi i egër vjeshte
Dhe për befasi çezme përjeton
Një ringjallje pak më ndryshe se njeriu

Tej kopshtit të mushmollave
Akoma presin fëmijët
Të shkrihen kallkanët
E vitit të kaluar

Një copë mjegulle bënë një hije
E cila i përngjan
Hijes së arrës te plepat e egër
Ku plakat e lagjes i krehin flokët
E thinjura të erës

E TËRA U DORËZUA

29 mars i një mëngjesi të hershëm
Kafshonte gurin e varrit
Të trokiturat nëpër portat e lagjes
I zgjuan fëmijët e pa lindur

Një vajë sa i trishtë
Po aq edhe çjerrës deri në pambarim
Në teatrin vetëvrasës të Prishtinës
Ia shqeu perden qiellit të ngrysur

Pas mesnatës së tërbuar
Filluan të shkasit trenat
E çmendur
Po shkasit edhe rrugët e kalldrëmta

Nëpër Grykën e Kaçanikut
Veturat i kishin ngritur
Flamujt e pikëllimit
Dhe dënesnin
Si fëmijët e humbur në mjegull

29 marsi i një viti të mbrapshtë
E tëra u dorëzua
Sa pa dhembje e dorëzoi atdheun
Ingranazheve të një ushtrie vrastare
Prishtinë, 03 dhjetor 2013

MU ATA GURË MERMERI

Mbi një pllakë të kuqe mermeri
Lëri shenjat e gishtave të erës
Pastaj shko në Kosovë
Shko atje te varret e vashave
Dhe mëso miku im
Mëso nga fëmijët bonjak
Se si duhet me dashtë atdheun

Me gishtat e tua prej plumbi
Preki vezullimet e yjeve
Ledhatoi përmendoret e delltë
Mu ata gur mermeri
Që nga gjeneza flasin shqip

Pranë portretit të kolonadave
Preki edhe flokët e thinjura
Të erës lozonjare
Preki degët e rrapit
Nëse do me i shijua
Pemët që rriten në syrin e lirisë

Prek çdo gjë sonte
Çka mund të preket me duart e tua
Edhe atë dritë të kuqe
Që buron nga ashti i tokës mëmë
Nën hijen e ati rrapi kryeneç
Preke edhe varrin tim
Po munde
Miku im i fëmijërisë

TI ISHE NË SYRIN TIM
-Baladë -

Me gjasa para lindjes sime
Ti ishe në syrin tim
Rrije ulur këmbëkryq
Dhe kryeneç si rrapet e Sharrit

I besojë rrënjëve të tokës
I besojë aq shumë sa që asnjëherë
Nuk e ndryshove mendjen
Moj tokë e lashtë dardane

Ti guri i stralltë i gjakut tim
Sa ishe kryeneçe po aq edhe krenare
Si zogu i shenjtë
U bërë ballë furtunave të egra

I përbuze trishtimet e deteve
Ti që linde nga zjarri i amshimit
Me mija vite
Nuk u shua prushi në shpirtin tënd

Kosovë vend i shenjtë i dardanëve
Pelegrinazh lirie
Sa herë që të zunë ngushtë
Po aq herë dole në ballë të bejlegut

Dole nga dheu dhe i dogje
Kuajt e drunjtë dardan
Kosova ime
Gjaku i gjakut tim
Që lulëzon
Si dashuria nëpër shekuj

MË DUHET PAK SHI

Është koha e mbjelljes së luleve
Njeriu më i lumtur se unë
S'mund të jetë askush
Përpos milingonës se blertë

Më duhet pak shi
Dhe pak oksigjen për frymëmarrjen e erës
Kësaj i them unë lumturi
Kur e ndjej rritjen e barit
Nën vetullat sybajame të pranverës

Mbase me të vërtet qenka koha e luleve
T'i mbjellim duart e gështenjave
Në shpirtin e këtij rrapi
Dhe të qeshim deri në menatë
Me këto grimca prej fluturimeve

Sot nuk qenka koha e pikëllimeve
Në çdo degë të pritjes
Shtrihen si iluzion fjalët e fluturës
Një dritë e dukshme përtej tunelit
I përshëndet trenat e gjelbër të pritjes

DRITA SI NJË GRUSHT I ZBRAZËT

Më duket se ishte
Ose duhej të ishte gjysma
E një nate
Kur filluan të kthehen zogjtë
Por diçka ishte e paqartë
Mes hijeve të zeza
Dhe asnjë fluturim nuk pat atë natë

Sterra dukej sikurse një gogol fushe
Herë ishte e zezë
E herë e verbët
Era me gishtat e saja të holla
E delikate
Prekte pa kurrfarë ndjenje bebëzën e syrit

Drita si një grusht i zbrazët
Depërtonte nëpër të çarat
E lisave të sëmurë
Hëna si një cung i lënë peng
Në malin e kujtimeve
Lëshonte në zemrën e dheut
Një dritë të zbehtë inkandeshente

KY BOSHLLËK PREJ PRITJEVE

Janë tharë
Ka kohë që u than degët
As era më
nuk loz me fëmijërinë tonë
Gjymtyrët e një druri të moshuar
Tani më duken si skelet
Dinozauri i ngrirë në hapësirë

Ju thash
Se janë tharë degët
E gjymtyrëve të një trupi të njomë
As puthjet tona më
Nuk janë askund
Mbase fluturuan me zogjtë shtegtarë
Deri te shpirtrat e drurëve

Ky boshllëk prej pritjeve
Po u përngjan
Tmerrësisht po u përngjan
Vetmisë së lisave
Vetmisë
E cila për çdo ditë mbetet fillikat
E ushqehet me gllënjkat e kujtimeve
Të haruara
Nëpër zarfe të kaltra

GJENEZA

Në një gotë gjysmë të zbrazur
Ka filluar
Ose që nesër do të filloj
Krijimi i trungut të vargut

Ky krijim me siguri do të ngjajë
Nëse arrijmë t'i bashkojmë fjalët
Dhe gjenezën e gurit
Do e kuptojmë
Se si i përngjan njeriu
Prejardhjes së dheut të shkriftë

E MË PAK SE SA NJË POET

Të lutem hapi portat e mbyllura
Sonte kam nevojë të hyj
Kam shumë nevojë
Të futem brenda fjalëve

Nëse ngjanë e kundërta
Mund të vdesin nesër
Si zogjtë e ngrirë të erës
Mund të vdesin
Gjymtyrët e metaforave

Më kujtohet
O fare mirë më kujtohet
Kur isha dikur dikush
Që i përngjante kryeneçësisë

Isha më shumë se një mbret
E pak më pak
Se sa një poet
Në shpirtin e fjalëve i mbolla metaforat

Më pastaj
Hyra në fshehtësinë e enigmave
Dhe me një mjeshtri të paparë
Ringjalla vdekjen e kalasë

Nga e cila
Herë zbritë mbreti
Me një pelerinë mëndafshi
E herë poeti mbështjellë
Me metafora të tejdukshme të gjetheve

EPITAF

desha si pikëllimin
I tëri u ngjiza
Me një trishtim
I harrova vuajtjet
Ëndrrat
Buzëqeshjet dhe gëzimin
Në fund të udhës kuptova
Se si jeta
Si xixë drite u shqim

Prishtinë, 04 dhjetor 2013

Eja të vdesim sonte
Cikli i dytë

KUR BIEN NGUSHTË POETËT

Kur bien ngushtë poetët
Me sy të mekur shikojnë qiellin
Nëpër xhepa të kallkanëve
I ndezin qirinjtë

Nëse dinë ndonjë lutje
Si të marrë i luten iluzionit
Perëndive nuk u besojnë
Kurse djajve aq më pak

Kur bien ngushtë poetët
I shikojnë pemët në shpirtin e njeriut
Si nga lindja ribëhen
Këndojnë psalmet e mykura

Kur bien ngushtë poetët
Mbase mbesin pa asnjë lutje
Edhe ashtu zhduken nga kotësia
Si perëndit e trilluar

MBETËN GISHTAT E TUA

Ti mendon
Se mund të më gjuash
Si komçat e thyera prej sedefi
Ose të më harrosh deri në atë masë
Siç i ke harruar ëndrrat e tua

Më lërë me vetminë time
Mos e provoko të kaluarën
Ajo iku si tërbimi i lumit
Iku përtej hijes së pjergullës
Atë menatë kur i harruam
Se si dukeshin
Duart e fishkura të erës

Mos mendo më për gjelbërimin
Nën fëshfërimën e gjetheve të verdha
Mbetën gishtat e tua
Mbetën si reliktet e një kohe
Në ëndrrat e dinozaurëve

Mos mendo më të lutem
Mos mendo për rrugën e qumështit
Yjet sontë po lindin në anën tjetër të qiellit
Po lindin të zbrazëta
Si trishtimet e së kaluarës

ËNDRRAT E MIA

Më së miri mund t'i shihni ëndrrat e mia
Në këtë akuarium të çeltë
Herë janë të veshura
Me një pallto të bardhë dimri
E herë
Të zhveshura deri në ashtë

Ato në dimrin e acartë
I përngjajnë merimangës
Kurse në pranverë vashave
Me taka të kuqe
Dhe i ngjyejnë buzët
Me shijen e qershisë së egër

Ngjanë që kur ikin menatë
Nga mendjet e shthurura të erës
Largohen me atë shpejtësi të dritës
Sa që nuk mund t'i zë
As ai i tejprëtejmes

Ëndrrat e mia
Ah vashat e mia të bukura
Sa herë që ktheheni në shpirtin tim
Zgjojen zogjtë e stinës
Nga mendja e erës
Dhe asnjëherë nuk i ndalin fluturimet

EJA TË VDESIM SONTE

Më duket se jam tepër i lodhur
Eja të vdesim sonte
Mbase vdiqa edhe dje
Nën pjergullën e fëmijërisë
Ishte koha e kometave
Kur nga stralli i kuq lindnin shirat

Të thash
Eja të vdesim si lulet
Nëse i përngjajmë gjelbërimit
Vdekja do të na duket si rritja e barit
Sa herë që e shfleton ditarin
Era loz me syrin e majtë të dritës

Të lutem
Eja të vdesim sonte
Sa është koha e lindjeve
Nëse vonohemi
Të tjerët do ta kenë privilegj për të vdekur
O të lutem mos u vono
Eja të vdesim sonte
Se do mbesim lakuriq pa ëndrra

HAPE TRASTËN E SHQYER

Përtej mendimit tim
Trajta e ngurtë e erës së verdhë
Hape trastën e shqyer
Dhe qitmi mbi këtë sofër
Të pritjes
Kafshatat e gatuara
Prej kësaj toke Dardane

Sa shumë paskanë uri sonte
Gjethet e fishkura të stinës
Kur pagëzohen yjet
Me emrat e ditëve të javës
Edhe trajta e erës vertikale
I përngjan
Patkonjve të betejës së humbur

Kjo shtrezë e murrme në rrënjën e barit
I përpiu të gjitha ngjyrat e klorofilit
Çdo pamje rreth hapave
Të mjegullave
Po e ndërron lëkurë
Nuk di a po i përngjan gjarpri gurit
Ose guri i kësaj mokre gjarprit

Prishtinë, 06 dhjetor 2013

EDHE SHIRAT E VERDHA

Kthehem në qytetin tim
Megjithatë
Edhe këtu s'mund të jetohet pa ëndrra
Nëpër ballkone të drunjta
Dalin vashat
Dalin me nga një lule vjollce në flokë

Freskia e lumëbardhit
Është po ajo që ishte dikur
Pak para ikjes tonë
Mushkonjat këtu nuk janë të bezdisshme
Ndoshta më duken si puthjet e adoleshencës

Ishin ato kohëra që mund të krahasohen
Pak me të sotmen e cila lëngon
Në shtratin e melankolisë
E pak më shumë me të kaluarën
Kohëra të ngarkuara me kujtime

Edhe shirat e verdha
Më duken se kanë ndryshuar
I përngjajnë etjes së tokës
Dhe dashurisë së vashës kryeneçe
Nuk bien më pingul si në fëmijërinë time

UDHËTARËT E VONUAR

Kjo stinë qenka e bezdisshme
Shirat po bien
Po reshin pa kurrfarë itinerari
Kanë filluar tu përngjajnë trenave
Dhe orëve pa akrep

Udhëtarët e vonuar
Nëpër valixhe i fshehin ëndrrat
Dhe si biban me kokë të ngritur
Shikojnë përtej maleve
Ikjet e trenave të mëngjesit

Bendi i përgjumur
Nuk e ndal ritmin e mërzitshëm
Te një muzike
Një valle e trishtuar s'di të ndalet
Era me një shami mëndafshi
I fshinë djersët e mëngjesit

ZËRI IM I NGJIZUR

Sonte ah sa frikshëm
Paskan filluar të bien perënditë
Po bien
Si trishtimet e një kohe

Zëri im i ngjizur
Nuk dëgjohet më askund
As në vetveten time të zbrazur
Sa qenka i shurdhër shpirti i plepit

Një korb i bardhë
Disa shekuj ditë me radhë
Po i han krahët e veta
Pa ndërpre çukit
Nëpër sytë e erës lozonjare

Zëri im po dobësohet
Bashkë me të reshurat
Asgjë më nuk është në vendin e duhur
Si murtaja po zhduken perënditë

DISA THIRRJE TË GJATA

Një stinë si shiu i pranverës
Hynë e del
Nga dhoma ime e gjumit
Në një sirtar të vjetër
Fotografish
Gjyshi im fle me një ëndërr të trishtë

Nuk guxon askush të ja prish gjumin
Ai fle në një sirtar të vjetër
Si një foshnje
Në gjirin e nënës
Kështu e ka gjyshi im i mirë

Ndonjëherë në thellësi të dërrasave
Dëgjohen disa lloje zhurmash
Të shurdhëta
Mbase grindet gjyshja me gjyshin
Ende edhe sot
Nuk e paskan harruar
Adetin e tyre të vjetër

Nëpër të qarat e drurit
Të grimcuar nga mizat dërrasave
Dalën sheshit
Disa thirrje të gjata
Që i përngjajnë zërit të gjyshit
Kur i grishte miqtë e fëmijërisë
Në mbrojtje të atdheut

NËPËR VARRET E LUFTËTARËVE

Derisa po bie ky shi i turbullt
Po bie si zëri i etjes
Ne do të luajmë me gishtat e erës
Tangon e fundit
Në absurditetin e një shekulli

Kjo kohë e brishtë
Në sqepin e zogjve shtegtarë
Brenda disa orëve
Prej një kontinenti në tjetrin
Kalon tejte trishtimit

I kujtohet fundosja e Titanikut
Dhe ikja e lejlekëve përtej stinëve
I kujtohet
Se si gjatë luftës së dytë botërore
Jehonin dhe nuk pushonin
Këngët e lirisë nëpër krematorët
E Evropës së çmendur

Mbase nuk dinë këtu të mejnë shirat
Po bien si mallkimet
E një shekulli
Po bien mbi lëkurën e djersitur të ditës

Po bien
Mbi eshtrat e karbonizuara
Që kanë zënë të mbinë këndeje pari
Si trishtimi i një enigme
Nëpër varret e luftëtarëve
Të njohur
Dhe të panjohur

UNË NUK DI

Nuk di se për çfarë i bëjë disa gjëra
Nga zemërimi ose nga dashuria
Kryesisht pandërprerë i bëjë
Prej një gabimi
Duke galopuar si kali i egër
Kaloj në gabimin tjetër

Kur në fund të rrugës
I shumëzoi
Të gjitha të ligat e mia
Dhe ato gjëra të tjera
Që janë pak më të mira
Përfundimisht kuptoj se në cilën anë
Anoi aq verbët syri im tekanjoz

Unë di që jam
Dhe kam qenë i papërmirësueshëm
Por jo kaq shumë
Sa që ta harroj emrin tim
Mbi atë gur varri

Unë nuk di
Se pse në fund të asaj rruge
Xhelozish i mbëltoj
Reliktet pagane
Dhe mëkatet e mia të para

NË KËTË UNIVERS

Miqtë e mi më njohin
Fare mirë i dinë huqet e mia
Të mira dhe ato të këqija
Unë për çdo ditë i ndërroj kapelat
Dhe këmishët që kundërmojnë
Një lloj djerse pa aromë

Por çfarë të bëjë
Kur nuk jam në gjendje ta ndërroj vetveten
Mund ta ndërroj emrin
Dhe mbiemrin në kartën e identiteti
Por ec e ndërro o njeri nëse mundesh
Egon tënde të pafrenueshme

Mund të bëjë një operacion plastik
Ta ndryshoj ngjyrën e syve
Hundës sime rrumbullake
Të ja jap një formë që i përngjan
Krejtësisht karotës së egër

Por gjithmonë ka ekzistuar
Një por
A jam në gjendje të iki nga vetvetja
Dhe ta ndryshoj botën time
Në këtë univers kaq të madh të trurit

BREGUN E MAJTË TË KUJTESËS

Kur mendojmë i shikojmë gjërat
E zbërthyera në qindra pjesë
Të pabarabarta
Një krah zogu si oreol profetësh
Qëndron në maje të plepit

Më tej duarve të erës
Një shakullinë e paparë ëndërron
Bregun e majtë të kujtesës
Ëndërron përmbytjen e zërit të mjellmës
Në kiçin e mbështetur
Për një dallgë deti

Për një copë druri të huazuar
Ne i ndryshojmë kahet e të gjitha mendimeve
Ecim për së mbrapshti si kali i paçjerrë
Jemi në gjendje t'i këpusim dizgjinët
Dizgjinët e fjalëve
Dhe të huazojmë nga era arkën e Pandorës

Kur mendojmë se ecim vertikalisht
Pas secilit hap mbjellim një lloj bari të egër
Dhe në mendimet e të menduarit fshehim
Xhelozish i fshehim kapelat e erës
Sepse nën çdo kapelë ka aq shumë të qara
Sa që kokat tona kanë erë sqfuri

ATDHEU NA MËSOI

Kur na merr malli
Vizatojmë një gurë mbi një grusht dhe
Hartën e atdheut
E nxjerrim nga ashti i rrapit
Dhe nuk i ndalim këngët
Deri në ndërrimin e stinëve

Me një grusht nostalgji
Dhe pak kripë
I kapërcejmë të gjitha detet
Hamë kur na zë uria
Gjumin e bëjmë në maje të plepit kryeneç

I dimë të gjitha burimet e fjalëve
Atdheu na mësoi
Se si duhet ta dashurojmë mështeknën
Na mësoi për shpirtin e qëndresës
E cila e mbanë gjallë flamurin

Krenohu flamuri im
krenohu sot për sot
Në fushën e nderit shtrihen
Mozaikët prej eshtrave
Shtrihen varret që kurrë nuk vdesin

Prishtinë, 07, 2013

JEMI AQ AFËR HIJES SË MURRME

Ditët më kalojnë pak më ndryshe
Se sa te tjerët
Një ditë jam i stërmbushur me ëndrra
kurse ditën tjetër
Një zbrazëti e padukshme
Lodron si kuajt e egër nëpër mua

Kur jam i vetmuar
Flas me drurët halor
Iu rrëfhem rrënjëve për hallet e mia
Të mirën dhe të keqen
I ndaj me gjethet
Kur kemi ushqim në trastë
Hamë deri sa përfundojmë kafshatën e fundit

Kurdoherë dhe nëpër çdo udhë
Ecim me njëri - tjetrin
Jemi aq afër hijes së murrme
Sa që kur na bashkohen mendimet
Ndryshojmë si kokrrat e klorofilit në vjeshtë

Ka raste kur gufojmë si qumështi
Por asnjëherë nuk e derdhim
Gotën e kristaltë të erës
Me shumë xhelozë fshihemi pas shakullinës
Nëse na zbulon
Çdo veprim fillojmë nga e para

PO BIEN SI GJETHET

Të gjithë shkuan në mol
Vetëm perëndit mbetën të vetmuar
Si statuja të ngrira
Në këtë boshllëk
Nuk dëgjohet as frymëmarrja e mizës

Shirat një kohë të gjatë
Nuk kanë të ndalur në qytetin tim
Po bien si gjethet
Me rrebesh stërkalash
Po bien si perëndit famëmadh

Më në fund
Në kokën time po fundosen trishtimet
Për kë të shkruaj këtë epitaf
Varret ikën diku tjetër
Po ikin edhe lejlekët përtej detit

Zëri shterur i erës fundoset
Në shpirtin e dallgëve të kripura
Në perëndim
Horizonti vallëzon me mjegullat
Mbase feston vdekjen e perëndive

NOSTALGJIA

Kur më zë etja
Skicoj një copë të vjedhur të diellit
Nën atë ikonë të mendimeve
Me xhelozë i mbaj të fshehur
Shejtanllëqet e fëmijërisë

Pastaj dalë fushave
I skicoj në mendje
Fluturimet e zgalemave
Dhe më vonë
Nëpër ajrin e tymosur të Prishtinës
I kërkoj zogjtë e ikur të viteve

Dikur vonë shumë vonë
Kur më zë për gryke nostalgjia
Me autobusin e parë dal nga lëkura ime
Dhe pi ujë burimi
Që gjarpëron grykave të Sharrit

KJO TRAGJEDI EPIKE

Hija ime e jeshilët
Ngjitur si një pullë postare
Për murin e kujtesës
Me një fytyrë të mishtë njeriu
Nuk i përngjan askujt
As vetvetes

Mbuluar i tëri në ferexhe
Me një lëkurë prej merimange
Kjo ikonë e verdhë
Më shumë i përngjan kashelashave
Se sa brushës
Së ndonjë piktori anonim

Sa kush që kalon nëpër dërrasat e teatrit
Parasysh e ka aktin e tretë
Ose zërin e harruar
Në piskamën e trishtuar të Othellos

Sa çel e mbyllë sytë
Këtu njerëzit përfundojnë
Nëpër istikame mendimesh
Kjo tragjedi epike
Nuk zgjatë vetëm një shekull

Këtu zërat pasi që bien
Si shirat në vjeshtë
Nuk përfundojnë në gijotinë
Dhe asnjëri nuk i frikohet vdekjes
Sepse kjo lindje e trishtuar
As që ekziston

NJË GRUA E MADHE

Nuk di por kur i çela sytë
Mu duke se dita kishte ikur tej maleve
Mirëmbërëma Kosovë
Mirëmbërëma
Etja ime e madhe

Por sot nuk qenka koha e mbrëmjes
Dielli paska lindur
Në anën e kundërt të horizontit
Mirëmëngjes Kosovë
Mirëmëngjesi dhembja ime e pashëruar

Ne jemi mësuar të këndojmë
Vetëm për të vdekurit
Të gjallët i varrosim
I varrosim shtatë pashë nën dhe
Mirëmbërëma ose mirëmëngjesi

Por ti Kosovë nuk je njeri
Je atdheu i jonë i paçmuar
Ke pirë sisë zane
Kosova ime krenare
Të kanë mëkuar bijat e universit

2.

Po vijnë kohërat e kallkanëve
Kurse dhjetori i acartë
Me sy shqiponje
Si një mal prej mjegulle
Po u bënë hije drurëve

Malet me tërë krenarinë e rrepave
Janë nisur për diku
Janë nisur
I pret një udhë e gjatë
Tepër e gjatë deri në mars

Rrënjët kanë dalë në pritë
Dhe presin me padurim
Lulëzimin e stinës
Te një gur i murrmë
Një nënë - zanë
Si herëve të tjera bekon atdheun

3.

Kur marsi i çelë sytë
Krah më krah hapen portat e qiellit
Një diell tjetër i madh
Ka zënë të ngjizet
Në hapësirën e përflakur të Dardanisë

Kalorësit veç janë nisur
Janë diku në fillim të marsit
Vetëtimat e nëntokës
Me qindra vite
Vetëtinë në shpirtin e Kosovës

Ja atje në Prekazin e Drenicës
Kalorësit e lirisë
Po i kashaisin
Me kashai prej dheu
Kuajt e paçjerrë të luftës

Në këtë rrugëtim të gjatë
Duke ecur
Prej një nëntori në tjetrin
Pamë kufoma fëmijësh
E gjinj të prera nënash

4.

Pamë
Oh çfarë nuk pamë
Në brendinë e zjarreve të prushtë
Kuaj të shkrumbuar
E potkonj të skuqur
Pamë mish të pjekur njeriu
Në sytë e ujkonjave të çartur

Pamë edhe zgavra sysh
Që lexonin në sytë tanë urrejtjen
Një tufë flokësh të verdha
Të një vashe
Si flamujt e pikëllimit
Valëviteshin mbi një gardh të djegur

Qante dhe nuk ndalej era
Me ngashërim të padëgjuar
Dëneste shiu i marsit
Gjethet në gjysmë shtize
I kishin lëshuar
Deri në tokë flamujt e pikëllimit
Ama s'kishin ndërmend
Kurrsesi të dorëzohen

5.

Po zbrazen fshatrat
Me shpirtra të boshatisura ecin kolonat
Nëpër trupin e mërdhirë të lisit
Fërshëllen syri i zgërbonjës

Një grua e madhe
Madhësia e së cilës
Matet me emrin nënë
Ecën në ballë të një kolone fëmijësh
Pas saj me hapa të rënda
Ecin pareshtur
Këmbët e zbathura mbi kristalet e dëborës

Një vogëlush flok kaçurrel
Fytyra e të cilit i përngjan Lekës
Me ashpërsinë e maleve dardane
Shkelë mbi kristalet e acarta të dimrit
Marshonte kryelartë
Pa e përfillur fërshëllimën e acarit

6.

Po zbresin nga malet
Po zbresin nëpër kolona
Gjethet e mështeknave
Një etje e paepur për liri
Bëhet prush
Në sytë e stralltë të rrapit

Nuk ndalet më ky lumë
Kanë zënë të rrokullisen gurtë
Po shkulen nga rrënjët
Barojat e këqija
Nga ndryshku i zinxhirëve
Ka zënë të fryj
Një aromë e këndshme bliri

USHTARI I VJETËR

Kalon nëpër kalldrëmet e qytetit
Ushtari i vjetër
Ecën duke i shikuar vitrinat
Kush e di
Se çfarë ka në kokën e plagosur
Cila betejë i paraqitet në ëndërr

Kur s'bisedon me askënd
Sytë e tij bojë qielli
I ledhaton flokët e kukullave
Nuk dihet
Se në cilën betejë i mbeti dora e djathtë
Dhe në cilin istikam ajo e majta
Ecën ky njeri
Ecën nëpër vetminë e vet

Një fjongo të kuçe
Mbanë në qafë
E mbanë për të mos e harruar plagën
Ecën ky njeri me vetminë e vetë
Ecën si i dehur
Nëpër trishtimet e istikameve të jetës

KU ISHA UNË

Ku isha unë
Kur ti dole nga balada
Dhe u bëre flakadan
Për atdheun e ndezur flakë

Mos vallë i përngjaja strucit
E fshihja kokën
Në dunat e kujtesës
Ose ecja
Në kahen e zhdrejtë të akrepave

Ku isha unë
Në cilin vend e fsheha kokën
Kur ti bisedoje me armikun
Nëpërmjet tytës së shpirtit

Ku jam unë sot
Dhe ku je ti
Çfarë bëra për atdheun që më ledhaton
Kurse ty
Po të kafshon si gjarpri
Miku im me nëntë plagë

Prishtinë, 08 dhjetor 2013

Një stuhi nate
Cikli i tretë

ËNDRRA

Unë di miku im
Se ti ke një ëndërr
E cila nuk i përngjan asnjë ëndrre
Ajo është e kaltër si zarfet
Që e bartin pëllumbat prej argjile

Ëndrra e jote është pak si ti
E pak më shumë si ëndrra e hijes tënde
Nëse i bashkoni duart e juaja
Të tejdukshme
Nga një qenie e mistershme
Mund të fluturojnë
Zogjtë më të bukur të gjumit

Unë di miku im
Se kur njeriu ëndërron
Që i përngjan ëndrrës së lumit
Ka vetëm një qëllim
Të mos zgjohet asnjëherë
Nga ai gjumë i imagjinuar

ÇFARËDO QË DESHA

Ti nuk mund të më japësh
Atë që s'e kam
Ecja ime është e gjatë
Nëse mbërri të takohem
Me vdekjen e gjetheve
Do të kem çdo gjë që më nevojitet

Pranë kësaj frymëmarrjeje të shthurur
Unë i fsheh ëndrrat e mia
Xhelozinë e kam mëri
Andaj kaloj rrugëve ballëhapur si era

Nuk mund të më zëni askund
Sepse frika askund
Nuk ekziston në fjalorin tim
Unë s'i dua ikjet
Nuk më pëlqejnë largimet e zogjve
Por sërish
U thuri oda fluturimeve të tilla

Ti jo se jo por edhe miku yt
Nuk mund të përngjani me mua
Unë kurrë nuk i kam dashtë gjërat
Prej të tjerëve
Çfarëdo që desha
Herët a vonë bëhej e imja

KUSH I LARGOI ESHTRAT

Një mal i ngarkuar me kafka
Kush i largoi eshtrat
Shiu i ngrohtë i vjeshtës
Mbase po i njomë
Kujtimet e një kohe të vrarë

Korbat e zinj herë largohen
Nga ky rrap
E herë kthehen
Me nga një daulle prej shiu
shpirtrat bartin një varr të panjohur
Mbi shpatullat e kryqit të dehidruar
Glasa sorrash

Vijnë edhe zogj të tjerë
Vijnë pareshtur
Për tu prehur në zgërbonjat e lisave
Gjethet shkunden ngadalë
Rrëshqasin si të molisura stinët
Mbi gishtat e thyera
Të një kambane
Po bien ciflat e kryqeve
Mbi varre të karbonizuara eshtrash

AS KY SHALL NUK MË DUHET

Kur e vë shallin në qafë
Më duket se
Ma zë frymën atdheu
Ai s'duron askënd të lidhet
Ashtu siç nuk është lidhur
Bajram Curri asnjëherë

Tregonte me krenari
Kësulë bardhi i maleve
Se vetëm njëherë
E ka lidhur nëna në djep
Dhe kurrë më
Nuk i duroi zinxhirët

Ende nuk u lind princ
E as mbret
Që mund ta lidhë lirinë
Andaj
As ky shall nuk më duhet
Ta simbolizojë robërinë

ME CA GJETHE DAFINASH

Secili njeri
Vdes në mënyrën e vet
Dikush duke u gjuhëzuar
Deri në përbuzje
E dikush tjetër ecën vertikalisht
Dhe mbërrin fund të rrugës
Me ca gjethe dafinash
Kurorëzuar si poet

MBI LËKURËN TIME TË ZESHKTË

I gjatë është ky dimër
Nëse i merr të gjitha kujtimet
Si mund të dalë në pranverë
Tregomë nënë
Tregomë se si duken emri i barit

Kam të ftohtë
Mbi lëkurën time të zeshktë
Po rrëshqasin stinët
Erërat belbëzojnë
Psalmet e shthurur të shiut

Sa më duket e rënd kjo çati
I tërë dimri mbase po peshon
Në shpirtin e saj të gjorë
Ti mos u bezdisë nënë
Më lërë të jetoj me kujtimet e tua

Mos ik sonte nënë
Të lutem mos ik si era e ndjekur
Me të gjitha kujtimet e tua
Çfarë do të mbetet pas teje
Dhe gurit të varrit
Të lutem nënë mos ik edhe sonte
Me erën e brymosur

PO LAHEN YJET E VERBËTA

Sonte nuk më zë gjumi
Mbase ngjanë se asnjëherë
Nuk kam fjetur kaq herët
Dukem si një anije e braktisur
Në mol

Në muret e plasaritura
Të heshtjes
Po lehin yjet e verbëta
Asnjë i qiri nuk bënë dritë
Në kujtesën e sfilatur të sterrës

Këto dallgë që po i rrahin
Bedenat e memories
Kush e di tani
Se nga cili ishull janë nisur
E po fundosen në gjolin e kripur
Si pëllumbat e egër
Në çastin e vetëvrasjes

Një peshk i rraskapitur
Bisedon me lotët e pulëbardhës
Derisa varka
Si përherë e vetmuar
Tundet mes për mes tërbimit të detit
Si djepi i një fëmijërie pa fëmijëri

UNË SHIKOJA QIELLIN STERRË

Isha shumë i uritur
Për kafjall hëngra bishën në mua
Për të tjerët
Asnjë kockë nuk lash për nesër

Dhe më pastaj mu duk vetja
Si një derr i ngopur
Në shtatë mëhallë
dëgjohej kundërmimi i gogësimës

Dikur vonë kah mesdita
Kur nisën të ngrehin kokë rropullitë
I ndala duart e shfrenuara
Të mos më dridhen si purtek çeliku

Stomaku filloi me hungërimin
E tij të zakonshëm
Shikoja qiellin sterrë
Që lehte në shpirtin tim
Si një qen i tërbuar
Hungëronte buzëmbremja e pikëlluar

Prishtinë, 09 dhjetor 2013

BASTUNËT

Sot kur u plakëm
Na lënë të gjithë pas dore
U harruam
Për çdo ditë nga pak
Shndërrohemi në duna prej hiri
Fëmijëria na duket një mollë e ndaluar

Nëpër rrugët e qytetit
Shëtisin vetëm bastunët
Që u përngjajnë
Skajshmërisht u përngjajnë
Kallkanëve të një dimri të largët

Ecin rrugicave të pista
Ecin ngjashëm somnambulëve
Në vetminë e moteve
Nën urat e qytetit përbirohen hijet

Asnjëherë nuk patëm kohë të mendojmë
Se dikur ishim të vegjël
Adoleshent të pa përmirësuar
Letrat që i shkruanim
Vashave të lagjes
U përngjanin zogjve të kaltër të qiellit

Shkruanim duke menduar
Se asnjëherë nuk do të plakemi
Si ky rrap i moçëm
Asgjë nuk na ka mbetur nga fëmijëria
As nga letrat tona
Përpos t'i kërkojmë ciflat e kujtimeve
Nëpër zgërbonjat e moshuara
Të drurëve halor

NË NJË HAPËSIRË GRI

Shkelim si somnambul
Pa mëshirshëm ecim nëpër brendinë
E syve të trishtuar të pasqyrës
Një ikonë e harruar në mur
Dënes si njeriu i humbur
I përditshmërisë sonë

Jashtë rrjetës së merimangës
Në një hapësirë gri
Një person i sëmur psikik
zhytet thellësive të pambarimtë
Të mendjes së Frojdit
Dhe nuk ndalet në asnjë shteg
I përngjan
Refrenit të një kënge kishtare

Jashtë në oborrin e shthurur të memories
Shirat veç kanë përfunduar misionin
Si zakonisht
I kanë sosur të gjitha punët
E varrtarëve
kanë mbetur të lyhen
Vetëm dërrasat e varrit
Të mbrohen
Nga mizat vrastare të dheut

SI NJË HIJE E MASKUAR

Erdhën zogjtë
Dhe hynë në mungesën tënde
Dhe sërish erdhën
Një tjetër lloj zogjsh të egër
Nata ishte e vetmja shpresë
Ku mund të pushonin
Turtujt e ikur të atdheut

Frynte një furtunë e hidhur
Një dorë e panjohur prej mjegulle
I shkulte rrënjët e lisave
Një çakall nate
Qante trishtueshëm
Me ngashërim të një fëmije
Dëneste qielli i ngrysur

Asnjeri nuk mbjelli lule te plepat
Një person pa duar
Si një hije e maskuar
Shkulte nga bagremët zërin e natës
Nata si një foshnje e braktisur
Dhe e harruar në faltore
Ishte shndërruar e tëra në vajë

E KA HAPUR EDHE ZEMRËN

Do të iki sonte
Do të iki nga këto dallgë mjerimi
Më presin diku në jug
Ujërat e turbullta të shirave
Do të më presin shpirtrat e stralltë
Të gurëve vendor

Kjo natë e skalitur
Me testamentin e dhembjes
I ka hapur duart
E ka hapur edhe zemrën
O ju lutem
Mos më mallkoni sonte
Më pret diku me padurim
Në copë mjegulle prej toke

Më presin miqtë
Të cilëve ua lash amanetin e fundit
Të më varrosin në atdheun tim
Të kem një grusht të vogël dheu
Pranë prindërve të mi
Mbi dyzetë vjet
Isha diku larg shijes së gështenjave
Dyzetë e më shumë vite
Nuk e ndjeva
Aromën e tokës së zhuritur

POR NE NUK U NDALËM

Shekuj me radhë
Lindjet i patëm nën hijet e lisave
Edhe vdekjet tona
U përngjanin drurëve
Ecnin maleve me një krenari epike
Dhe për nga pamja
U përngjanin gjyshërve

Si nëpër veshin e gjilpërës
Depërtuam ledheve të historisë
Ngjante ndonjëherë
Të ishte si një nënë e mirë
E në të shumtën e rasteve
Na varroste
Për së gjalli kjo njerë e keqe

Por ne nuk u ndalëm
Ecjen e patëm në gjakun e rrënjëve
Sa herë që deshi të na ndalte hovin
Ky Ballkani i çmendur
Ne ecëm edhe më shumë
Dhe mbërrimë triumfalisht
Deri në majat e gjetheve

KJO KOHË E METEORËVE

Si nëpër një ëndërr të trishtë
I dëgjoj thirrjet e shirave
Mjegullat i shalojnë retë e arratisura
Mbi krifat kuajve
Si në pranverë galdojnë rrufetë

Një hënë diku në brigjet e hapësirës
Për herë të parë
Kungohet me shirat e shenjta
Kambanat dhe kryqet dolën nga baladat
Një diell krejtësisht ndryshe
Po zbret nga Lindja

Kjo kohë e meteorëve
Paska një britmë të egër mali
Nuset për herë të parë
Në tokën tonë të shenjtë
Sot herët në mëngjes
I shaluan
Kuajt e paçjerrë të luftës

Prishtinë, 10 dhjetor 2013

NJË STUHI NATE

Era e sfilitur si e çmendur
Kalonte nëpër zgërbonjën e rrapit
Kalonte andej
Nëpër ëndrrat e dimrave të gjata
Ku flinin drurët kryeneç

Gurtë e murrme pëlqitnin nga acari
Në shtatëdhjetë e shtatë pjesë
Çahej lisi
Era si e trentë
Vetëm njëherë në ditë
Kalonte fshehurazi
Nëpër damarët e fishkur të përroit

I tërë mali dridhej nga zëri i stuhisë
Dridheshin nga furtuna
Edhe arinjtë e bardhë
Nën duhmën e rënd të një shpelle
Dridhej e përdridhej
Një stuhi nate

Herët në mëngjes
Si zërat e pandalshme të kafshëve
Filloi të ulërinte mali
Bjeshka rrinte ulur këmbëkryq
Shikonte me habi lojën e drurëve halor

SI NJË SIRENË PREJ UJI

Kur ti me flokët e tua prej ere
Do të na paraqitesh
Si një sirenë prej uji
Unë atëherë
Do jem pjesë e një harrese
E tejpushme në pasqyrën e mëngjesit

Nëpër varrin tim të heshtur
Do të vrapojnë
Si të azdisura s'do të ndalen milingonat
Ti do i krehësh flokët e erës
Me krehrin tënd prej mjegullave

Kalimtarët ndoshta do të ofshajnë
Për herë të parë
Do ndjehem i hutuar
Dhe i huaj në shtëpinë time

Si mund të heshtë njeriu
Si dheu
Kur kaq shumë epitafe
I lexoi
Te varret e krishterëve

DËNESTE BASHKË ME ERËN

Ndodhë që nëpër disa ëndrra
Hyjë me sy të hapur
I preki gjërat
Që kurrë nuk janë prekur
Pastaj largohem
Tërma! zhgëndrës sime
Dhe bëjë një gjumë të dyshimtë
Te kallamishtet

Kur zgjohem pas një kohe
Ndoshta gjumi im
Ka zgjatur disa vjet me radhë
I kërkoj nëpër stërnishtat e djegura
Kubet e humbura të zareve
Dhe zbres i dehur
Deri në fund të ëndrrës

I hutuar si bufi
I shikoj njerëzit e shastisur
Kah vallëzojnë si të babëzitur
Tangon e fundit në shi
Dëgjoj muzikën e fëmijërisë
Më kujtohet çasti
Se si qante dimri mbi një lis
Dëneste bashkë me erën
Kur varrosej lagjja

MË DUKET SE U BË VONË

Ky peizazh nëpër të cilin
Kanë zënë të arratisen mbrëmjet e vonuara
Hyri në shpirtin tim
Dhe si një zog rebel
Çukiti nëpër trungun familjar
Të erës së dërmuar

Eci nëpër historinë e legjendave
Kur në fund të rrugës
U takua me enigmat e sëmura
Kuptoi se si qante mermeri i kuq
Kur mes kolonadave
Një dorë e zezë e padukshme
I shkulte kryqet e një kohe pagane

Më duket se u bë vonë
Kthimi i zogjve ishte i pamundur
Lejlekët e fundit
Që fluturuan për në jug
Nëpër disa lugje të verdha
I lënë vezët
Dhe kurrë më nuk u kthyen
T'i marrin erë zambakëve të kuq

Prishtinë, 11 dhjetor 2013

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën “Pionieri”, më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahës krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetatat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990*, nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002 Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e

karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar “Fahri Fazliu”, në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”,** poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. **“Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëdarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. **“Thirrje e gjakut”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu” Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. **“Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë, “Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.

15. **“Pema e bekuar”**, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. **“Bajraktarët e vatanit”**, poezi satirike, Klubi letrar, “Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”**, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18. **“Stuhi në Kutulishte”**, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. **“Posa ikte nata”**, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. **“Loja e myshqeve”**, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. **“Lumëbardhi dhe gjëma”**, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. **“Metafora e heshtjes”**, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. **“Hyji në Prekaz”**, poezi, “Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. **“Sinorët e hinore”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **“Don Kishoti dhe Rosinanti”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26. **“Zjarri i dashurisë”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **“Kur likenet vallëzojnë”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28. **“Ditari në vargje”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2010.
30. **“Shtegu i mallit”**, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31. **"Korniza e thyer"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **"Zgjimi i gjëmës"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
33. **"Vallja mistike"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **"Merre kodin"**, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot, 2011
35. **"Letër atdheut"** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **"Tejdukshmëria e shiut"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2011
37. **"Përtej teje"**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **"Sa afër e sa larg"** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **"Vallja e zanoreve"**, Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2011
40. **"Ikja e eshtrave"**, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2011
41. **"Kalorësit e mjegullave"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **"Hingëllimat e shiut"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **"Kur pemët i ndërrojnë këmishët"**. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
44. **"Mirëmëngjes Imzot"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2012
45. **"Kafshimi i mikut"**, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **"Atje tej maleve"**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2012
48. **“Portat e shpresës,”** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
50. **“Kinse Lojë Shahu,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
52. **“Fusha e mëllenjave,”** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
53. **“E kujt është kjo vetmi,”** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
54. **“Mos pyet për adresën e lumit,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55. **“ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. **“Urori i stralltë,”** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2012
57. **“Po të mos ishte fjala,”** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2012
58. **“Thyerja e urave,”** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2012
59. **“ Trokëllimat në gjumin e dallgëve,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
60. **“ Në flokët e dëborës,”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61. **“Një grusht nostalgji,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit,”** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2012
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
66. **“Fëmijët e erës”**, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
- 69, **“ Më pëlqejnë mendimet e tua”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70. **”Andej dhe këndej kohës”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71. **“Zëri i heshtjes”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
72. **“Kush i lexoi letrat prej erës”**, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73. **“ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”**, prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
- 75.” **Diku te një baladë”**, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76. **“ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
- 77 **“ Ky def prej hëne”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
- 78.**“Pyesni zogjtë në ikje ”**,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013

79. “**Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80. “**Refrene yjesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. “**Te delta e mjellmave**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82. “**Rinjohja**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83. “**Diku në fund të një fillimi**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84. “**Makthi i hijes**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85. “**Një zog prej uji**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot
86. “**Asnjë fjalë nuk frymon**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu” Kastriot, 2014
87. “**Daullet e një nate**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot ,2014
88. “**Sytë e gurtë të erës**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot, 2014
89. “**Kur dehen perënditë**” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot ,2014
90. “**Fjetëm njëqind shekuj**”Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot , 2014
91. “**Krakëllimat e natës**”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot, 2014
92. “**Ndjekësit e enigmave**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot ,2014
93. “**Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shoqate e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu” Kastriot, 2014

- 94. "Psalm i harruar "**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"Kastriot 2013
- 95,"Për kë po bie moj kambanë"**, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot, 2013
- 96. "Mbi flokët e ullukëve"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013
- 97. "Menatë vijnë lejlekë"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013
- 98. "Loti i gotës së dehur"** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013
- 99. " Stina asnjënëse"** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013
- . 100"Dëneste bashkë me erën"** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013

PËRMBAJTJA

Prej shiu të tejdukshëm - Cikli i parë	9
Mos harro	11
Netët janë të gjata	12
Sa ora zhdukej njeriu	13
Secili prej nesh	15
Ulen vetëm nëpër ato vende	17
Edhe ne ishim	18
Dënesnin fluturat krah thyer	19
Sërish i pash dy zogj	20
Kur vinte mbrëmja	21
Atje në fund të lagjes	22
E tëra u dorëzua	23
Mu ata gurë mermeri	24
Ti ishe në syrin tim	26
Më duhet pak shi	28
Drita si një grusht i zbrazët	29
Ky boshllëk prej pritjeve	30
Gjeneza	31
E më pak se sa një poet	32
Epitaf	32
Eja të vdesim sonte - Cikli i dytë	35
Kur bien ngushtë poetët	37
Mbetën gishtat e tua	38
Ëndrrat e mia	39
Eja të vdesim sonte	40
Hape trastën e shqyer	41
Edhe shirat e verdha	42
Udhëtarët e vonuar	43
Zëri im i ngjizur	44
Disa thirrje të gjata	45

Nëpër varret e luftëtarëve	47
Unë nuk di	49
Në këtë univers	50
Bregun e majtë të kujtesës	51
Atdheu na mësoi	52
Jemi aq afër hijes së murrme	53
Po bien si gjethet	55
Nostalgjia	56
Kjo tragjedi epike	57
Një grua e madhe	59
2.	60
3.	61
4.	62
5.	63
6.	64
Ushtari i vjetër	65
Ku isha unë	66
Një stuhi nate - Cikli i tretë	67
Ëndrra	69
Çfarëdo që desha	70
Kush i largoi eshtrat	71
As ky shall nuk më duhet	72
Me ca gjethe dafinash	73
Mbi lëkurën time të zeshkët	74
Po lahen yjet e verbëta	75
Unë shikoja qiellin sterrë	76
Bastunët	77
Në një hapësirë gri	79
Si një hije e maskuar	80
E ka hapur edhe zemrën	81
Por ne nuk u ndalëm	82
Kjo kohë e meteorëve	83

DËNESTE BASHKË ME ERËN

Një stuhi nate	84
Si një sirenë prej uji	85
Dëneste bashkë me erën	86
Më duket se u bë vonë	87

,

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem

Dëneste bashkë me erën / Adem Zaplluzha. -
Kastriot : Shtëpia botuese “ Fahri Fazliu”, 2014. -
101 f. ; 21 cm.

Shënime biografike për autorin : f. 89-97

ISBN 978-9951-664-10-3